

Perceptimet e qytetarëve të Kosovës për ekstremizmin e dhunshëm dhe riintegrimin dhe rehabilitimin e të kthyerve





QKSS
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

Autor:

Shpat Balaj

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me ligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të transmetohet në çfarëdo forme apo mjete elektronik, mekanik apo tjetër pa lejen me shkrim të botuesit. Nuk lejohet shfrytëzimi komercial i asnjë materiali të botuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) pa lejen me shkrim të QKSS-së. Ju lutemi të kontaktoni: info@qkss.org ose +383 38 221 420.

Të dhënat e paraqitura në këtë raport janë nga sondazhi i Barometrit të Sigurisë në Ballkanin Perëndimor (BSBP). BSBP është një nismë e re rajonale e filluar nga QKSS në vitin 2020, e cila zbatohet në bashkëpunim me Qendrën e Beogradit për Politikën e Sigurisë (BCSP) në Serbi dhe Qendrën për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG) në Shqipëri, e mbështetur nga National Endowment for Democracy (NED). BSBP shërben si një instrument për të matur perceptimet e publikut në Shqipëri, Kosovë dhe Serbi për çështje të ndryshme të lidhura me sigurinë. Të dhënat tregojnë se si qytetarët i perceptojnë apo informohen rreth çështjeve të paraqitura në këtë raport. Si të tilla, pikëpamjet e paraqitura në këtë raport nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e QKSS, BCSP, CSDG ose NED.

Ky raport në formën e tij origjinale është shkruar në gjuhën Angleze.

Projekti financohet nga::



Konkursiumi drejtohet nga:



Perceptimet e qytetarëve të Kosovës për ekstremizmin e dhunshëm dhe riintegrimin dhe rehabilitimin e të kthyerve



PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	1
HYRJE	2
KËRCËNIMET E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM NGA KËNDVËSHTRIMI I QYTETARËVE	6
PRANIM APO PËRJASHTIM? PËRCEPTIMET E QYTETARËVE PËR RIINTEGRIMIN DHE REHABILITIMIN E TË KTHYERVE	9
OBSERVIMET KYÇE	10



PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Qytetarët e Kosovës vazhdojnë ta perceptojnë ekstremizmin e dhunshëm si kërcënim për sigurinë kombëtare të Kosovës. Shumica (76%) e të anketuarve të BSBP-së besojnë se ekstremizmi i dhunshëm paraqet kërcënim të lartë ose kërcënim për Kosovën. Sa për format e ekstremizmit të dhunshëm, qytetarët e Kosovës e shohin dhunën në baza etnike/kombëtare si më kërcënuesen, me 42 për qind të të anketuarve që mendojnë se ajo paraqet kërcënim të lartë për sigurinë e Kosovës. Dhuna në baza politike perceptohet si kërcënim i lartë për sigurinë e Kosovës nga 38 për qind e të anketuarve të BSBP-së, ndërsa dhuna në baza fetare perceptohet si kërcënim nga 34 për qind e të anketuarve. Kosova, si shtetet tjera evropiane, është përballur me sfida sa i përket pjesëmarrjes së qytetarëve në konfliktet e huaja. Të dhënat e BSBP-së tregojnë se 37 për qind e të anketuarve i shohin qytetarët që janë kthyer në Kosovë nga zonat e luftës në Siri dhe Irak si kërcënim për vendin.

Përkundër sfidave, është e rëndësishme të theksohet se të dhënat e BSBP-së tregojnë se kosovarët e mbështesin punën e qeverisë së Kosovës për riatdhesimin e qytetarëve nga Siria. Kështu, 65 për qind e të anketuarve mbështesin riatdhesimin e të gjithë qytetarëve që janë ende në Siri, ndërsa 15 për qind mendojnë se duhet të riatdhesohen vetëm gratë dhe fëmijët e mbetur. Qëndrimet pozitive vërehen në perceptimet e qytetarëve për qasjen që duhet të zbatohet ndaj atyre që kthehen nga zonat e konfliktit në Siri. 75 për qind e të anketuarve besojnë se qasja/masat e ndërmarra nga institucionet e Kosovës duhet të fokusohen në riintegrim, për dallim nga 11 për qind që besojnë se të kthyerit duhet t'u nënshtrohen masave ndëshkuese dhe shtatë për qind e të anketuarve që besojnë se nuk ka nevojë për ndonjë masë specifike. Një rezultat mjaft shqetësues vërehet në lidhje me gatishmërinë e qytetarëve për t'i pranuar dhe mirëpritur sërish në komunitet fëmijët që janë kthyer nga Siria dhe Iraku. Në këtë aspekt, shumica e të anketuarve (57%) nuk do të lejonin që fëmijët e tyre të shoqëroheshin me fëmijët e riatdhesuar, pasi që besojnë se ata mund të kenë efekt negativ tek fëmijët e tjerë. Nga ana tjetër, 35 për qind e të anketuarve nuk do ta kishin problem të lejonin që fëmijët e tyre të shoqëroheshin me fëmijët e kthyer.



HYRJE

Prej viteve 2011–2012, kur mbi 400 qytetarë të Kosovës iu bashkuan grupeve terroriste në konfliktin sirian, mbi 250 prej tyre janë riatdhesuar në Kosovë. Pas riatdhesimit të tyre, ata kanë kaluar një proces rehabilitimi dhe riintegrimi (R-R), përmes programeve të krijuara nga institucionet e Kosovës, të cilat ishin të orientuara drejt dy qasjeve të përgjithshme: masave ndëshkuese–restauruese dhe mbështetjes për riintegrim social.¹ Disa raporte hulumtuese tregojnë se përveç efektshmërisë së institucioneve të sigurisë, sukseset në rehabilitim dhe riintegrim në Kosovë vijnë edhe si rezultat i kohezionit të fortë social që buron, ndër të tjera, nga lidhjet e forta të komunitetit. Marrë parasysh këtë, opinioni i qytetarëve të Kosovës për çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me ekstremizmin e dhunshëm dhe R-R të të prekurve nga ky fenomen, është shumë i rëndësishëm për formësimin e angazhimit të tyre në fusha të tilla. Ky raport përbëhet nga dy pjesë. Pjesa e parë ofron një pasqyrë të rezultateve të perceptimeve të publikut në Kosovë në lidhje me kërcënimet që rrjedhin nga forma të ndryshme të ekstremizmit të dhunshëm. Kurse pjesa e dytë fokusohet në perceptimet e qytetarëve në lidhje me R-R të qytetarëve të Kosovës të riatdhesuar nga Siria, si dhe në gatishmërinë e tyre për t'i pranuar këta të fundit në komunitetet e tyre përkatëse.

Sa i përket metodologjisë, të dhënat për këtë raport janë mbledhur në kuadër të anketës së Barometrit të Sigurisë në Ballkanin Perëndimor (BSBP), përmes intervistave sy më sy me të anketuar të përzgjedhur rastësisht në mbarë Kosovën. Hulumtimi në terren është kryer nga data 17 shtator deri më 25 shtator 2021. Pyetësi i anketës përbëhet kryesisht nga pyetje të mbyllura në formë të shkallës Likert me pesë pikë, të pasuara nga disa pyetje të hapura pa opsione të paracaktuara. Mostra kombëtare për anketën përfshinte 1,197 amvisëri. Faza e parë e tërheqjes së mostrës u bazua në njësitë administrative të drejtorive rajonale të Policisë së Kosovës, duke përfshirë tetë rajonet: Ferizaj, Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë të Jugut, Mitrovicë të Veriut, Pejë, Prishtinë dhe Prizren. Numri i anketimeve të kryera në secilin rajon u përcaktua në përpjesëtim me numrin e popullsisë për secilën komunë brenda rajoneve përkatëse bazuar në regjistrimin e popullsisë në Kosovë të vitit 2011. Brenda komunave, mostra u shtresua në mostër urbane/rurale bazuar në numrin e amvisërive në secilën zonë. Për përzgjedhjen e amvisërive brenda lokaliteteve të mostruara u përdorën modele të rastësishme, ndërsa rastësia brenda amvisërive u bazua në metodën e ditëlindjes e radhës së të rriturve. Të dhënat u verifikuan në kohë reale përmes koordinatoreve në terren që vizituan një mostër të paracaktuar të amvisërive pas përfundimit të anketimit në amvisëritë përkatëse, përmes kontaktit telefonik me të gjithë të anketuarit, për të konfirmuar respektimin e metodologjisë dhe disa nga përgjigjet kyçe, si dhe duke analizuar konsistencën logjike të përgjigjeve gjatë përpunimit dhe analizimit të të dhënave. Marzha i gabimit është 3 për qind me një interval besueshmërie prej 95 për qind.

1. Ilazi, R. dhe Perteshi, S., 2020. Zbërthimi i përgjigjes së Kosovës ndaj të kthyerve nga zonat e luftës në Siri dhe Irak. 01/2020. Prishtinë: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Në dispozicion në: <https://qkss.org/images/uploads/files/violent-extremism-eng_978757.pdf>.




KËRCËNIMET E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM NGA KËNDVËSHTRIMI I QYTETARËVE

Viteve të fundit, vendet e Ballkanit Perëndimor u përballën me sfida të ndryshme për sigurinë dhe stabilitetin e tyre nga forma të ndryshme të ekstremizmit dhe radikalizimit. Teksa në pesë vitet e fundit ekstremizmi në baza fetare është parë si shqetësim kryesor në rajon për shkak të pjesëmarrjes së individëve nga rajoni në konfliktet e huaja në Siri, Irak dhe Ukrainë, forma të tjera të ekstremizmit, si ekstremizmi etnik dhe politik, janë duke u bërë shqetësuese. Për më tepër, marrë parasysh se Rusia shihet si një aktor i huaj keqdashës në Ballkanin Perëndimor, aktiviteti i grupeve mercenare nga rajoni dhe pjesëmarrja e tyre në zonat e konfliktit në Ukrainë në mbështetje të politikës ruse, përkeqësojnë shqetësimet e sigurisë dhe përforcojnë frikën për një mjedis mundësues për ndikim më të madh rus në rajon.²

Edhe pse institucionet e Kosovës kanë ndërmarrë hapa konkretë për parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm, si dhe për riintegrimin dhe rehabilitimin e të prekurve nga ky fenomen, komuniteti në Kosovë vazhdon ta shohë riskun potencial të llojeve të ndryshme të ekstremizmit. Kur të anketuarve të BSBP-së iu kërkua të vlerësonin se sa kërcënim paraqet ekstremizmi i dhunshëm për sigurinë kombëtare të Kosovës, 76 për qind deklaruan se ky fenomen paraqet kërcënim të lartë ose kërcënim.

TABELA 1 PERCEPTIMI I QYTETARËVE PËR NIVELIN E KËRCËNIMIT QË PARAQET EKSTREMIZMI I DHUNSHËM PËR SIGURINË KOMBËTARE TË KOSOVËS




Veç kësaj, diskutimet e lehtësuara nga QKSS-ja me komunitete të ndryshme në Kosovë, nxjerrin në pah faktin se qytetarët shohin një lidhje ndërmjet formave të ndryshme të ekstremizmit dhe e njohin efektin e disa faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në nxitjen e radikalizimit dhe ekstremizmit.³ Për më tepër, rezultatet e anketës së BSBP-së të vitit 2020 theksojnë edhe vetëdijësimin e qytetarëve të Kosovës në lidhje me kërcënimet nga forma të ndryshme të ekstremizmit të dhunshëm. Në vitin 2020, 38 për qind e të anketuarve të BSBP-së në Kosovë e perceptonin si kërcënim të lartë dhunën e motivuar politikisht. Ngjashëm, 22 për qind e shihnin dhunën etnike/kombëtare si kërcënim të lartë, të ndjekur nga 17 për qind që e konsideronin dhunën në baza fetare si kërcënim të lartë për sigurinë e Kosovës.

2. Velebit, V., 2017. Luftëtarët serbë në Ukrainë vazhdojnë ta shqetësojnë Perëndimin. Ballkani Perëndimor Evropian, Në dispozicion në: <https://europeanwesternbalkans.com/2017/12/29/serb-fighters-ukraine-continue-worry-west/>

3. Për shembull, shih: <https://www.pave-project.eu/news/kcss-holds-stakeholders-committee-meeting-in-kosovo>; <https://www.pave-project.eu/news/focus-group-in-north-mitrovica>


Në anketën e këtij viti të BSBP-së, vërehet një rritje e dukshme e perceptimit të qytetarëve për rreziqet që paraqesin për vendin radikalizimi etno-politik dhe ekstremizmi i djathtë. Teksa në vitin 2020 dhuna e motivuar politikisht perceptohej si formë e ekstremizmit me potencialin më të lartë për ta rrezikuar sigurinë e Kosovës, të anketuarit e anketës së BSBP-së të vitit 2021 e shohin ekstremizmin etno-politik si më kërcënues për sigurinë kombëtare. 42 për qind e të anketuarve mendojnë se dhuna me motive nacionale/etnike është kërcënim i lartë për Kosovën. Ngjashëm, nga këndvështrimi i 38 për qind të të anketuarve, dhuna politike – e definuar si dhunë ndërmjet akterëve politikë dhe mbështetësve të tyre të vendosur dhe nënprodukt i tensioneve dhe polarizimit të shtuar politik – mbetet kërcënim i lartë për sigurinë e Kosovës. Nga ana tjetër, teksa dhuna në baza fetare vazhdon të jetë forma e ekstremizmit që të anketuarit e BSBP-së e renditin si më pak kërcënuese, përqindja e atyre që e perceptojnë si kërcënim të lartë është dyfishuar nga viti i kaluar. Përkatësisht, 34 për qind e të anketuarve e konsiderojnë si kërcënim të lartë dhunën në baza fetare, ndërsa 33 për qind besojnë se Kosova nuk është aspak e kërcënuar nga kjo formë e ekstremizmit.

TABELA 2 PERCEPTIMET E QYTETARËVE PËR NIVELIN E KËRCËNIMIT QË PARAQESIN FORMAT E NDRYSHME TË EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM PËR SIGURINË KOMBËTARE TË KOSOVËS



Përveç matjes së perceptimeve të qytetarëve për kërcënimet e formave të ndryshme të ekstremizmit, përmes anketës së BSBP-së ne kemi analizuar edhe nëse të anketuarit i shohin si kërcënim për komunitetet e tyre qytetarët e Kosovës që kanë marrë pjesë si luftëtarë në konfliktin e Sirisë (në tekstin e mëtejshëm: luftëtarë të kthyer) dhe që janë riatdhesuar në Kosovë. Prandaj, pyetjet për luftëtarët e kthyer i kemi integruar në kontekstin e sigurisë për të analizuar nëse qëndrimet në lidhje me sigurinë mund të paraqesin pengesë për gatishmërinë e qytetarëve për t'i pranuar këta në komunitetet përkatëse, duke paraqitur vështirësi për R-R-në e tyre. Në këtë aspekt, 37 për qind e të anketuarve i perceptojnë luftëtarët e kthyer si kërcënim për sigurinë kombëtare të Kosovës; 37 për qind besojnë se paraqesin kërcënim deri diku, ndërsa 21 për qind mendojnë se nuk paraqesin aspak kërcënim.

TABELA 3 PERCEPTIMI I QYTETARËVE PËR NIVELIN E KËRCËNIMIT QË PARAQESIN PËR SIGURINË KOMBËTARE TË KOSOVËS QYTETARËT E KOSOVËS QË KANË MARRË PJESË SI LUFTËTARË NË KONFLIKTIN E SIRISË DHE QË JANË RIATDHESUAR NË KOSOVË.




PRANIM APO PËRJASHTIM? PËRCEPTIMET E QYTETARËVE PËR RIINTEGRIMIN DHE REHABILITIMIN E TË KTHYERVE



Pas riadhesimit të qytetarëve të Kosovës nga zona e konfliktit në Siri, institucionet e Kosovës dhe organizatat e shoqërisë civile kanë krijuar dhe zbatuar aktivitete dhe programe të ndryshme për të siguruar rehabilitimin dhe riintegrimin e të kthyerve. Hulumentimet e mëparshme të QKSS-së kanë theksuar se kohezioni i fortë social i ndërtuar si rezultat i lidhjeve të forta familjare dhe të bashkësisë e ka bërë komunitetin e Kosovës më rezilient ndaj çdo forme të ekstremizmit dhe në të njëjtën kohë ka luajtur rol të rëndësishëm për R-R-në e të kthyerve.⁴ Prandaj, duke theksuar perceptimet e qytetarëve për çështje të ndryshme që lidhen me të kthyerit, synojmë të analizojmë nëse perceptimet e komunitetit të gjerë ndaj të kthyerve mund të ndikojnë në këtë kohezion social.

Marrë parasysh se një numër i qytetarëve të Kosovës vazhdojnë të mbesin në territorin e Sirisë, të anketuarve të BSBP-së iu kërkua të japin opinionin e tyre nëse institucionet e Kosovës duhet të punojnë për riadhesimin e këtyre. Shumica e të anketuarve (65 për qind) mendojnë se të gjithë qytetarët duhet të riadhesohen nga Siria. Nga ana tjetër, 15 për qind e të anketuarve mendojnë se institucionet e Kosovës duhet t'i riadhesojnë vetëm gratë dhe fëmijët, duke i konsideruar ata si jo luftëtarë, ndërsa 13 për qind mendojnë se institucionet e Kosovës nuk duhet t'i riadhesojnë ata që kanë mbetur në territorin e Sirisë.


TABELA 4 | A BESONI SE INSTITUCIONET E KOSOVËS DUHET T'I RIADHESOJNË QYTETARËT E KOSOVËS QË JANË ENDE BRENDIA TERRITORIT TË SIRISË?



Rezultatet e anketës së mëparshme të BSBP-së (2020) kanë nxjerrë në pah mungesën e informacionit të qytetarëve në lidhje me aktivitetet dhe programet për R-R që targetojnë të kthyerit. Vitin e kaluar, 75 për qind e të anketuarve kishin pohuar se nuk kanë ndonjë informacion në lidhje me aktivitete dhe programe të tilla. Marrë parasysh mungesën e informacionit për këto programe, në vitin 2021 kemi analizuar nëse qytetarët besojnë se programe të tilla duhet të ekzistojnë. Kur të anketuarit e BSBP-së u pyetën se cila qasje është më e përshtatshme për trajtimin e të kthyerve jo luftëtarë, tre të katërtat e tyre (75%) deklaruan se qasja rehabilituese është më e përshtatshme, përkundrajt 11 për qind që besojnë se ndaj të kthyerve duhet të zbatohet një qasje ndëshkuese. Shtatë për qind e të anketuarve besojnë se të kthyerit nuk duhet t'i nënshtrohen asnjë mase.

4. Ilazi, R. dhe Perteshi, S., 2020. Zbërthimi i përgjigjes së Kosovës ndaj të kthyerve nga zonat e luftës në Siri dhe Irak. 01/2020. Prishtinë: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Në dispozicion në: <https://qkss.org/images/uploads/files/violent-extremism-eng_978757.pdf>.

TABELA 5 CILA QASJE/MASË MENDONI SE ËSHTË MË E PËRSHTATSHME PËR TRAJTIMIN E TË KTHYERVE JO LUFTËTARË?



Në mesin e qytetarëve të riatdhesuar nga Siria, ka një numër të konsiderueshëm fëmijësh që janë kthyer me të paktën një prind, jetim, dhe më rrallë me të dy prindërit. Ngjashëm me të gjithë të kthyerit, me kthimin e tyre, procesi i R-R-së së tyre filloi menjëherë me fokus të veçantë në integrimin e tyre në sistemin e rregullt arsimor të Kosovës. Megjithatë, edhe pse ka pasur përparim të konsiderueshëm në integrimin e tyre në përgjithësi dhe integrimin e tyre në sistemin arsimor në veçanti, gjetjet e QKSS-së nga hulumtimet dhe vëzhgimet në aktivitetet tona me fëmijët e kthyer, tregojnë prirje për stigmatizim të këtyre fëmijëve, pasi që ata ndajnë një ndjenjë të përbashkët të izolimit nga komuniteti i gjerë. Veç kësaj, rezultatet e BSBP-së, si në vitin 2020 ashtu edhe në vitin 2021, tregojnë mungesën e gatishmërisë së komunitetit për t'i pranuar fëmijët e kthyer, duke qenë se një pjesë e madhe e të anketuarve nuk ndihen të sigurt për t'i lejuar fëmijët e tyre të shoqërohen me fëmijët e kthyer. Në vitin 2020, 55 për qind e të anketuarve deklaruan se nuk do të lejonin që fëmijët e tyre të shoqëroheshin me fëmijë të riatdhesuar nga zonat e konfliktit, ndërsa 32 për qind nuk e kishin problem këtë gjë. Në vitin 2021 shohim një qëndrim të ngjashëm të qytetarët; 57 për qind e të anketuarve mendojnë se nuk do të lejonin që fëmijët e tyre të shoqëroheshin me fëmijët e riatdhesuar, ndërsa 35 për qind shprehën gatishmërinë për t'i lejuar. Arsyet për këto qëndrime lidhen kryesisht me frikën e komunitetit se fëmijët e riatdhesuar janë potencialisht më të prirur ndaj radikalizmit dhe si të tillë mund të ndikojnë negativisht tek fëmijët e tjerë.

TABELA 6 GATISHMËRIA E QYTETARËVE PËR T'I LEJUAR FËMIJËT E TYRE TË SHOQËROHEN ME FËMIJËT E KTHYER





OBSERVIMET KYÇE

Qytetarët kosovarë janë ende të shqetësuar nga ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizimin etno-politik e shohin si shqetësim të madh. Ka shumë gjasa që një perceptim i tillë ndikohet nga rritja e lëvizjeve të ekstremit të djathtë në BE si dhe në rajon (p.sh. Dveri dhe Leviathan në Serbi). Veç kësaj, izolimi i vazhdueshëm i kosovarëve nga BE-ja, si rezultat i vonësive në marrjen e një vendimi pozitiv për liberalizimin e vizave, përforcon perceptimin e qytetarëve se janë viktime të narrativave të ekstremit të djathtë kundër Kosovës. Nga ana tjetër, siç u argumentua edhe më herët në këtë raport, hulumtimet tregojnë se rezultatet më të mira në këtë fushë vijnë edhe falë angazhimit të komunitetit si akterë parësorë në përpjekjet e institucioneve për parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit. Andaj, këto rezultate duhet të shihen si mundësi për dizajnimin e angazhimit të komunitetit për të ndërtuar më tej reziliencën e komunitetit kundrejt të gjitha formave të ekstremizmit të dhunshëm. Në këtë drejtim, strategjia e re kundër ekstremizmit të dhunshëm duhet të përshtatet duke pasur parasysh rolin e komunitetit dhe akterëve lokalë në Kosovë, dhe si e tillë të jetë gjithëpërfshirëse. Kjo duhet parë si një nga arsyet pse duhet të shmanget integrimi i strategjisë kundër terrorizmit në strategjinë kundër ekstremizmit të dhunshëm, ose të parashikohen plane të veçanta veprimi për kundër-terrorizmin, parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, dhe R-R. Sekuritizmi i tepruar i një strategjie të tillë parandalon përfshirjen e akterëve pa sfond sigurie në aktivitetet e strategjisë në fjalë dhe potencialisht i izolon iniciativat për ta parandaluar dhe luftuar ekstremizmin e dhunshëm vetëm brenda spektrit të sigurisë. Për më tepër, këto rezultate mund të shihen edhe si thirrje për decentralizimin e punës me të kthyerit nga Siria. Në këtë drejtim, është shumë e rëndësishme që të sigurohen njohuritë dhe mjetet e nevojshme për nivelin lokal, puna e të cilit i afron ata me komunitetet, dhe për rrjedhojë ka ndikim të drejtpërdrejtë në informimin e komuniteteve dhe formësimin e opinioneve të tyre për çështje të ndryshme, përfshirë ekstremizmin e dhunshëm, të kthyerit etj.

Veç kësaj, rezultatet e BSBP-së tregojnë se përveç punës efektive të institucioneve për parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm, si dhe për R-R të të prekurve nga ky fenomen, institucionet duhet të bëjnë punë më efektive për vetëdijësimin e qytetarëve për çështjet që lidhen me këto tema. Në këtë aspekt, institucionet e Kosovës duhet të hartojnë dhe zbatojnë një strategji komunikimi që targeton komunitetet lokale në mënyrë që ata të informohen dhe të përfshihen në mënyrë proaktive në procesin e R-R, rrjedhimisht të punojnë për rritjen e gatishmërisë së komunitetit për t'i pranuar të kthyerit, veçanërisht fëmijët. Për më tepër, gjatë aktivitetëve të QKSS-së me fëmijët e kthyer, kemi vërejtur se brenda shkollave dhe komuniteteve të tyre ata shoqërohen kryesisht me njëri-tjetrin dhe janë më të distancuar nga fëmijët e tjerë. Andaj, Ministria e Arsimit, në bashkëpunim me institucionet lokale, duhet të aplikojë një qasje më proaktive në përpjekjet e tyre për riintegrim, duke hartuar një plan gjithëpërfshirës për integrimin e plotë të fëmijëve të riadhesuar në shkollat publike dhe risocializimin e tyre brenda sistemit arsimor. Ndërtimi i qasjeve specifike ndaj elementeve të ndryshëm të R-R është jashtëzakonisht i rëndësishëm për të siguruar që aktivitetet në këtë fushë të mos mbeten ad-hoc, por të jenë më tepër pjesë e një tabloje më të gjerë, gjithëpërfshirëse dhe konsistente.

Katalogimi në botim **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës - "Pjetër Bogdani"

329:316.736(496.51)"2022"
(047)

Balaj, Shpat

Perceptimet e qytetarëve të Kosovës për ekstremizmin e dhunshëm dhe riintegrimin dhe rehabilitimin e të kthyerve : anketa e WBSB në Kosovë : raporti i shtetit #2 : 2022 / Shpat Balaj. - Prishtinë : QKSS, 2022. - 14 f. : ilustr. ; 28 cm.

Ekstremizmi -- Kosovë -- Aspekte sociologjike -- Raporte -- 2022
Të kthyerit -- Riaftësimi

ISBN 978-9951-799-58-4

Aleph [000101302]



ISBN 978-9951-799-58-4



9 789951 799584

